REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2018:071674

Datë: 02.10.2020

Numri i dokumentit: 01160322

P. nr. 454/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË/ DEGA MALISHEVË- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me zyrtaren ligjore Albane Morina, në lëndën penale kundër të akuzuarit M. G. nga fshati S., Komuna e K., për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/II. nr. 561/18, të datës 14.12.2018, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datën 08.07.2020, në prezencën e prokurorit te shtetit Enis Gashi, të akuzuarit M. G., **më 13 korrik 2020 nxjerr dhe publikisht shpalli këtë:**

A K T G J Y K I M

I akuzuari **M. G.,** nga i ati B. e ëma Sh. e gjinisë Th., i lindur më datën ..., nga fshati S., Komuna e K., shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, më parë i dënuar, i martuar, ati i 4 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, punon në firmën "A." në fshatin M., Komuna e Malishevës, me numër personal ....

ËSHTË FAJTOR

Më datën 14.11.2017, rreth orës 19:15 min, i pandehuri M. G., ka shkuar në ''V. F.'', në Malishevë, dhe me qëllim që vetit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, i merr pasurinë të dëmtuarës ''V. F.'', në atë mënyrë që mbush një karrocë dore përplot me gjera ushqimore dhe largohet nga objekti e shkon në drejtim të makinës së tij, në parking pa kryer pagesën, dhe pasi që e vëren sigurimi të njëjtin, e ndjek dhe e kap duke i futur në makinë gjërat ushqimore në vlerë prej 137.89 €, ku më pas i merr gjerat dhe i kthehet në V.. F..

-me çka ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4,7,17,41,42,43,46,47,73,74,75,76,325 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit i shqipton:

2018:071675

DËNIM ME GJOBË DHE DËNIM ME BURGIM

Ashtu që i akuzuari M. G. dënohet me dënim me gjobë në shumë prej njëqind (100) Euro, të cilin dënim është i detyruar ta paguaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata në bazë të nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-së dënimin me gjobë do ta zëvendësoj me dënim burgimi në kohëzgjatje prej pesë (5) ditësh, duke llogaritur për çdo ditë të qëndrimit në burgim, nga njëzet (20) Euro.

DHE

DËNIM ME BURGIM I CILI DËNIM ME PËLQIMIN E TË PANDEHURIT ZËVËNDËSOHET NË DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të pandehurit **M. G.**, për veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditësh, i cili dënim në bazë të nenit 47 të KPRK-së dhe me pëlqimin e të pandehurit **M. G.**, i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej nëntëqind (900) Euro, të cilin dënim i pandehuri do ta paguaj në afat prej nëntë (9) muajsh, në këste të barabarta.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguaj dënimin e zëvendësuar me gjobë, atëherë dënimi i zëvendësuar me gjobë do të revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditësh.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumën prej 30,oo €, si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 20 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara V.F. në M., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, në këtë gjykate ka paraqitur aktakuzë PP/II. nr. 561/18, të datës 14.12.2018, kundër të akuzuarit M. G. nga fshati S., Komuna e K., për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar me dt. 08.07.2020, dhe pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të pandehurit iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

Pas deklarimit të pandehurit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë.

Prokurori i shtetit jep mendimin, se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit duke marrë parasysh që i njëjti këtë pranim e beri me vullnet te plotë pasi që i ka kuptuar të

2018:071675

drejtat, favoret dhe pasojat e pranimi te fajësisë te deklaruar nga ana e gjykatës, po ashtu duke e marrë për bazë që aktakuza ka mbështetje ne prova personale dhe materiale ne bazë të cilave është paraqiturat gjendja faktike ne dispozitiv të aktakuzës, ku edhe formohen të gjitha elemente e veprës penale me te cilën ngarkohet i akuzuari.

I pandehuri M.G., deklarohet i fajshëm për akuzën, pasi që gjërat të cilat ceken ne aktakuzë të njëjtat nuk i kam marruar por i kamë kthyer, këtë vepër e kamë bere pasi që i ka më pasur kushtet ekonomike shumë të vështira, kam qenë i pa punë, dhe për mi mbajtur anëtaret e familjes, si katër fëmijët e mi, gruan dhe prindërit e mi ku të gjithë kemi qenë pa punë, i premtoj gjykatë së nuk do të përsëris vepër tjetër penale, ndjej keqardhje për rastin.

Nga thëniet e vet të pandehurit në shqyrtimin fillestarë u vërtetua se aj me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: raporti fillestar i incidentit nr.... dt. 14.11.2017; raporti policor mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit-dëmtuari G. Sh. nr.... dt.14.11.2017; raporti policor mbi marrjen në pyetje të dyshuarit/ pandehurit M. G. nr..... dt.14.11.2017; foto dokumentacioni ....; raporti i oficerit B. B. # ... nr. .... dt. 14.11.2017, si dhe shkresat tjera të lëndës.

Gjykata me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës. Gjykata ka aprovuar deklarimin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri dhe vlerëson se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që ka kryer i pandehuri, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarimin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri e ka pranuar si të tillë.

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 73, 74 të KPRK-së, ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, të njëjtën e ka bërë pasi që i ka pasur kushtet shumë të vështira ekonomike për qëllim për me i mbajtur anëtarët e familjes, ndien keqardhje për rastin, i premton gjykatës se nuk do të përsëritë vepër tjetër penale, i gjendjes së dobët ekonomike, ndërsa si rrethana rënduese gjykata gjeti se i akuzuari ka qenë i dënuar edhe më parë nga kjo gjykatë dhe atë: 1. i dënuar me dënim komulativ me gjobë në shumën prej 200 Euro dhe me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 3 muajve, sipas lëndës penale P.nr. 364/18 dt. 11.02.2020 i plotfuqishëm me 20.03.2020, për veprën penale nga neni 325 par. 1 të KPRK-së; dhe 2. i dënuar me dënim komulativ me gjobë në shumën prej 300 Euro dhe me burgim në kohëzgjatje prej 4 muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës prej 1 viti nuk kryen vepër tjetër penale, sipas lëndës penale P.nr. 426/18 dt. 05.12.2019 i plotfuqishëm me 23.03.2020, për veprën penale nga neni 325 par. 1 të KPRK-së, të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e matjes së dënimit të parapara me nenin 73 të KPRK-së, Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim me gjobë në shumën prej njëqind (100) Euro, **dhe me dënim** me burgim në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditësh, i cili dënim në bazë të nenit 47 të KPRK-së dhe me pëlqimin e të pandehurit **M. G.**, i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej nëntëqind (900) Euro, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

2018:071675

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2. 6 të KPPK-së, si dhe bazuar në nenin 39 par. 3 nën par. 3. 2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit nr. 05/L-036.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 365 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË/ DEGA MALISHEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P. nr. 454/18, Datë: 13 korrik 2020

Zyrtarja ligjore,
Albane MORINA

_____

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Njazi MORINA

_____

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.